



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 1666/1 Prot
Dt. 17.03.23

Shkodër, më 15.03.2023



Nr. 209/1 Prot.

Lënda: Mbi Vendimin nr. 11, datë 27.02.2023 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", i ndryshuar, neni 56, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja "a", neni 18, neni 27, pika 5, neni 54, shkronja "e/1", neni 55, pika 3, neni 64, shkronja "c", të ligjit nr. 57/2020 "Për pyjet", neni 25, pika 1, shkronja "a", të VKM nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike, sipas listave te inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive", të ndryshuar, pika 49, shtojca 47, të VKM nr. 559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për vëprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", tabela 6, të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", të VKB Vau Dejës nr. 3, datë 25.01.2023 "Mbi miratimin e listës së ngastave/nëngastrave pyjore të gatshme për dhënie në përdorim", të shkresës së Këshillit të Bashkiak Vau i Dejës nr. 1658 prot., datë 03.03.2023 "Dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, datë 27.02.2023", shqyrtoi VKB nr. 11, datë 27.02.2023 "Për miratimin e dhënies në përdorim me afat 10 vjeçar të sipërfaqes pyjore prej 0.126 ha, për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe turistike, kampingje, kënde lojrash, mjedis sportive, shplohëse, kulturore, etj., në ngastrën nr. 106, në ekonominë pyjore Gomsiqe".

Pas shqyrtimit, Prefekti ju autorizon procedimin, sipas procedurave të konkurimit publik ne vazhdim.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

Nr. 11 datë 27.02. 2023

“Për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 0.126 ha “për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për veprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj në ekonomitë pyjore Gomsiqe .

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja “el”, neni 18 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 57/2020, date 30.4.2020 “Për Pyjet”, neni 25, **pika 49** e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërkimit,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” **me shumicë të cilësuar votash.**

V E N D O S I

1. Dhënies në përdorim të sipërfaqes prej **0.126** ha “për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për veprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj”, në **ngastrën nr.106** të ekonominë pyjore **Gomsiqe**.
2. Vlëra e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM **nr.559, datë 29.07.2022** “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore” shtojca nr 1 pika 8:6.
3. Efektet: Jep impaktë pozitive tek komuniteti , sigurohen të ardhura të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.
4. Ngarkohen Drejtoria e pyjeve, Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

K R Y E T A R

Mark Bisha

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Ardian Çelepija

Miratuar me 19 vota

Vota Pro 19

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 03.03. 2023